



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me Primljeno:	29.07 20 22	
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
15-463/02-40551		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 17 dhe 19 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Gazeta zyrtare 2019/10 data 03.04.2019, Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463/02-17286 të datës 31.03.2022, si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.463/01-17245 të datës 31.03.2022 për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Konjuh, Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit bën këtë:

NJOFTIM

PËR ANULIMIN E NJOFTIMIT PUBLIK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS Nr.1-463/06-24409 I DATËS 13.05.2022

- I. NJOFTOHEN të gjithë aplikuesit për marrjen në shfrytëzim të pronës komunale se **ANULOHET** Njoftimi publik për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës Nr.1-463/06-24409 i datës 13.05.2022 si dhe të gjitha veprimet juridike të ndërmarra përkitazi me këtë Njoftim publik.
- II. Ky njoftim publik hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni Vlerësues.

Arsyetim

Anulimi i Njoftimit të cekur dhe procedurave të zhvilluara sipas tij bëhet për shkak se gjatë hartimit të raportit për shpalljen e fituesve nga ana e Komisionit Vlerësues janë vërejtur - evidentuar disa gabime teknike në raport me aplikimin e pagesës përkatësisht është aplikuar gabimisht dispozita e nenit 6 të Rregullores për Taksa Komunale 15Nr.353-35821 e datës 30.06.2021 te pjesa tabelare, numri rendor 13.

Komisioni gjatë vizitës në terren gjithashtu ka evidentuar se kemi të bëjmë me uzurpim të pronës e cila është e shpallur për dhënien në shfrytëzim në Njoftimin publik, me ç'rast është proceduar tek organet kompetente komunale që të zhvillohet procedura për lirim të pronës së paluajtshme komunale.

Komisioni Vlerësues në mënyrë unanime poashtu konstaton se pjesa dërmuese e aplikimeve të shqyrtuara të subjekteve aplikuese kanë prezentuar projekte të përgjithshme dhe jo konkrete si dhe në raport me vlerën e pronës aplikimet duhet të jenë të përgaditura qartë dhe në mënyrë konkrete nga aplikuesit.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Njoftimi.

Nr: 15-463/02-40551

Datë: 29.07.2022

1. Valon Pacolli, Kryesues i Komisionit



2. Latif Ramadani, anëtar



3. Armend Grajqevci, anëtar



4. Lulzim Rustemi, anëtar



5. Arbenita Gërxhaliu, anëtar

